



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI KOMUNËS - SHITIME

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr.01-060/01-10308/22 datë: 22.04.2022



Npi – 01/101 datë: 27.04.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 27.04.2022 nxjerr këtë:

E K S T R A K T **PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 27.04.2022 (e mërkurë) në ora 10.00 h. në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Heroina Selmani. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, z.Shpëtim Gashi, zyrtar për informim, znj.Valmira Hoxha, praktikante.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Raporti tre mujor buxhetor Janar-Mars 2022,
2. Propozim-Vendim për bartje të mjeteve nga kategoria e rezervës në projekte kapitale,
3. Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MAPL, Nr.04-416 dt. 5.04.2022,
4. Propozim-Vendim për caktimin e lokacioneve për Qerdhe në fshatrat Godanc i ulët dhe Petrovë,
5. Propozim-Plani Lokal i Verprimit për Biodiversitet 2021-2026

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, Pajtohem me rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Raporti tre mujor buxhetor Janar-Mars 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Përshëndetje, po e nisi me të hyrat vetanake ku e kemi një vlerë me minus 1% në raport me vitin 2021. Nuk është diferencë e madhe. Donacionet, kemi nga DKA-ja një donacion prej mbi 10 mijë euro. Financim nga huamarrja, është e veçantë, ku janë shpenzuar 1,782.00 € për 2019-2021. Në raport me buxhetin janë shpenzuar 15.90% ndërsa në raport me alokimet janë shpenzuar 29.71% . Në tabelën raportuese janë të paraqitura në mënyrë më detale

për secilën kategori ekonomike se sa janë shpenzuar. Dokumentin e keni marrë dhe e keni lexuar, nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; A mundesh me na i sqaru Kapitalet?

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Në vazhdim ky lexoi të dhënat në dokumentin e raportit (shih dokumentin).

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, unë kërkoj nga zyra e Kryetarit, një pasqyrë më të detajuar për shpenzimet te zyra e Kryetarit.

z.Përparim Ramusa; Te të hyrat vetanake në raport me pandeminë që kemi pas shkalla prej minus 1% është pak shqetësuese. Dhe e dyta projektet nuk kanë filluar në teren, si dhe projektet që kanë qenë dy vjeqare ende nuk kanë filluar që të realizohen kjo është shqetësuese. Unë kërkoj që të aprovohet raporti me këto vërejtje logjike.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i rekomandoi Kuvendit, miratimin e Raportit tre mujor buxhetor Janar-Mars, 2022, me vërejtjet e z.Përparim Ramusa që 1. Është shqetësuese shkalla e inkasimit të hyrave vetanake me minus 1% në krahasim me vitin e kaluar kur dihet që e kemi të përmirësuar gjendjen me pandeminë Kovid19. 2. Po ashtu është shqetësues fakti se ende nuk kanë filluar zbatimi i projekteve kapitale në teren, e as i atyre dy vjeqare që janë në vazhdimësi. znj.Adelina Beqaj, Kërkoj një pasqyrë më të detajuar për shpenzimet te Zyra e Kryetarit të Komunës.**

Pika 2

Propozim-Vendim për bartje të mjeteve nga kategoria e rezervës në projekte kapitale

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Sa i përket kësaj pike mund të them se një gjendje e tillë për riemërtimin e projekteve po na përcjell edhe këtë vit. Këtë vit i kemi 5 projekte të cilat duhet të riemërtohen. Ju e keni marrë Propozim-Vendimin për këtë pikë me kohë por unë do ti lexoj këto 5 projekte (Shih dokumentin).

z.Përparim Ramusa; Sa është shuma totale e kësaj bartje që duhet të bëhet?

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Shuma totale është 86,530.00€

z.Përparim Ramusa; Në bazë të elaborimit që u bë nuk kemi arsye mos me e votu, kështu që unë mendoj se nuk ka nevojë me e zgjatë më shumë, i rekomandojmë Kuvendit për aprovim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit për bartje të mjeteve nga kategoria e rezervës në projekte kapitale.**

Pika 3

Rishqyrtimi i Rregullores Komonale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MAPL, Nr.04-416 dt. 5.04.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Materialin për këtë pikë e keni marrë, dhe e keni vërejtë se tash për herën e dytë na i ka kthyer Ministria e Drejtësisë Rregulloren Komonale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba për 2022, për rishqyrtim. Në vazhdim lexoi tekstin e pjesës ku duhet të ndryshohet Rregulloja për Taksa. Pastaj nuk kanë nevojë me qenë në rregullore dy pikat neni 3.1 dhe neni 3.3.1 sepse është Ligji për Kunbdërvajtje ku janë të parapara. Te neni 13 kërkohet një riformulim të cilin e kam dhënë në dokument. Unë ju ftoj që ta votoni këtë ndryshim, dhe nëse ka ndonjë pyetje jam gati të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Në aspektin e taksave nuk është elaboruar. Unë kërkoj që zyrtari ligjor në mbledhjen e Kuvendit të na sqaroi saktësisht se qka duhet të ndryshohet në rregullore.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Edhe mua po më intereson me ditë se pse në të kaluarën kjo ka kaluar si e tillë e tani jo.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Ndoshta pse kanë ndryshuar politikat e mëhershme të MAPL-së në raport me Ministrinë e Drejtësisë. Osë ndoshta e din zyrtari ligjor se për qka. Ndërsa sa i përket riformulimit të tekstit po besoj se gjithqka është e qartë.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, i bashkëngjitem Përparimit, që të ipet sqarime nga zyrtari ligjor, por që nuk ka pas sukses, kërkoj që para materialit me na ardhë një opinion ligjor nga zyrtari ligjor.

z.Përparim Ramusa; Ne nuk jemi kundër taksave, por vetëm të harmonizohet, dhe kur kthehet në aspektin ligjor, zyrtari ligjor të jep një opinion.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MAPL, Nr.04-416 dt. 05.04.2022, me vërejtjen që kjo të kontrollohet dhe të harmonizohet, nga zyra ligjore.**

Pika 4

Propozim-Vendim për caktimin e lokacioneve për Qerdhe në fshatrat Godanc i ulët dhe Petrovë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; A ka ndonjë reagim nga banorët e fshatrave.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në Godanc nuk ka vërejtje, lokacioni është i përshtatshëm. Ndërsa në Petrovë, kemi një reagim nga lagja Ademaj, me arsyetimin se në lokacionin ku është propozuar nga DPUKGJ-ja ka varreza.

znj.Adelina Beqaj; Më datën 23.04.2022 ditë e shtunde kemi pas një takim me banorët e fshatit ku kemi diskutuar për lokacionin për Çerdhe. Njëri nga banorët ka thënë se nëse Komuna e merr përsipër që të zhvendosen varrezat si dhe të konstatohet ADN-ja mund të pajtohem. Ne nuk mundemi me marrë vendim për ndërtimin e një Çerdhe mbi varreza. Ka propozime që Çerdhja me u ndërtuar të vendi i quajtur Kodra e Mullirit, mirëpo ka shpenzime shtesë për infrastrukturë.

z.Përparim Ramusa; Një pyetje, vitin e kaluar nuk kemi paraparë buxhet për këtë Çerdhe, atëherë donacion i kujt është ky projekt, e tek pastaj të diskutojmë për lokacionin. Për sa i përket Petrovës duhet të shkojë me miratimin e banorëve të fshatit, ndërsa sa i përket fshatit Godanc na nevojitet kohë, ku duhet të mirret parasysh largësia, numri i banorëve. Kështu që unë propozoj që kjo të shkojë pa rekomandim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Shumën e saktë nuk e di, mirëpo e di që ky është projekt qeveritarë, ku do Çerdhe do të ndërtohen edhe në Muzeqinë ku përfshihen një numër i fshatrave të rrafshit, ndërsa në Godanc kemi më së shumti fëmijë që përfshihen fshatrat Godanc i epërm, Godanc i ulët, dhe një pjesë e Lagjes së Pajtimit, por edhe një pjesë e Zborcit mund të përfshihet.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi, që për këtë pikë mos të ketë rekomandim fare por të shkojë direkt në Kuvend.**

Pika 5

Propozim-Plani Lokal i Verprimit për Biodiversitet 2021-2026

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; Unë po propozoj që Hamza me e elaboruar më detaishtë, pastaj edhe drejtori i ri dhe pastaj të aprovohet, nëse nuk ka nevojë për me dale në diskutim publik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mendoj se është ide e mirë.


z.Përparim Ramusa; Pajtohem me propozimin e Adelins që të aprovohet, nëse nuk është obligative me dalë në diskutim publik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Planit Lokal të Verprimit për Biodiversitet 2021-2026.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi, mbledhjen e përfundoi në ora 11:29h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

